

## VENDIMET E MBLEDHJES SË BORDIT

### Vendimi Nr. 2024-01

#### Pjesëmarrja e trajnerit Senad Jusufi në Konferencën “Developing Technicaly and Tacticaly Junior players.”

Bordi miratoj kërkesën e trajnerit Senad Jusufi për pjesëmarrje në konferencën e trajnereve “Developing Technicaly and Tacticaly Junior players”, që do mbahet më 09-10 Mars në Sofie- Bullagari.

Senad Jusufi do të marr pjesë në këtë konferencë ndërsa shpenzimet e pjesëmarrjes, transportit dhe akomodimit do t’i mbulojë FTK.

### Vendimi Nr. 2024-02

#### Ëheelchair project’s 2024

Pas thirrjes nga ITF për grante të tenisit në karroca, bordi mori vendim që FTK të aplikojë për herë të parë për ëheelchair project’s, dhe kësaj radhe për organizimin e një kampi të tenisit në karroca. FTK do bëjë aplikimin në ITF për këtë projekt granti i së cilës sillet rreth 2,500 USD.

Përveç këtij kampi, FTK do aplikojë edhe për pesë (5) karrocë profesionale për tenis.

### Vendimi Nr. 2024-03

#### Rritja e mëditjeve për refer

Bordi miraton kërkesën e KRTK për rritjen e mëditjeve për referim të turneve, nga 40 euro në 50 euro.

Referët do kompesohen me 50 euro për ditë, ndërsa përkrahjet tjera do bëhen sipas rregullorës financiare për financa, procedura dhe rregulla.

### Vendimi Nr. 2024-04

#### Përkrahjet e tenistëve në 2024

Bordi miraton propozimin e Hadërgjonaj për përditësimin e rregullave për rimburesimet e tenistëve në 2024. Administrata bashkë me këshillin profesional gjatë ditëve në vijim do bëjnë angazhimin në përditësimin dhe hartimin e politikave të reja të cilat do hedhën në bord për votim dhe do hyjnë në fuqi pas miratimit nga bordi.

### Vendimi Nr. 2024-05

#### Kompensimi i Kryetarit me Pagë fikse

Bordi me shumicë votash merr vendim për kompensimin e Kryetarit me pagë fikse për anazhimet e tij në FTK. Kryetari i FTK-së do kompensohet me pagë në lartësi 690 euro, ose 15% më të lartë se Sekretari.

Me hyrjen e këtij vendimi në fuqi, shfuqizohet vendimi për mëditjet e Kryetarit.